

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSPEKTORATIN SHETETËROR TË MJEDISIT DHE PUJEVE ME OBJEKT “ MBI VLERËSIMIN E AKTIVITETIT EKONOMIK DHE FINANCIAR PËR PERIUDHËN 01.01.2014-31.12.2014.

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në ISHMP, me objekt “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar” për periudhën 01.01.2014 deri 31.12.2014 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 46, datë 28.4.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën e K L SH me nr. 26/7 datë 30.04.2015 “ Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse”, i janë dërguar z. Ergus AGASI, Kryeinspektor i ISHMP, rekomandimet dhe zbatimi i masave të mëposhtme:

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Referuar konstatimit për parregullsitë në raportimet e Kompanisëpër vetmonitorimet e treguesve në mjedis, referuar nenit 32/3 të ligjit të ligjit nr.10 431, datë 9.6.2011”Për mbrojtjen e mjedisit”, raportime që kishin dhe mangësi në periodicitetin e raportimit, cilësinë dhe vërtetësinë e raportimit si dhe përputhshmërinë me kërkesat e lejeve dhe të legjislacionit në fuqi, *me synim mbrojtjen e mjedisit dhe ndëshkimin e operatorëve* që nuk zbatojnë detyrimet ligjore në fuqi, konform përcaktimeve në nenin 69“kundërvajtjet”, *rekomandoj*:

-Komunikimin zyrtar periodik midis ISHMPU si dhe AKM për çdo vlerësim të Raporteve të vetmonitorimit, në zbatim të nenit 32/3 dhe nenit 65/1 ligjit nr.10 431, datë 9.6.2011”Për mbrojtjen e mjedisit” me konstatime të parregullsive që bien ndesh me kërkesat e lejeve dhe kërkesat e ligjeve specifike që preken nga veprimtaria e operatorit.

Në vazhdimësi

2. Referuar faktit të mungesës së një programi të rehabilitimit të zonës së ndotur , nga funksionimi i aktiviteteve të jashtë kushteve të lejeve mjedisore, për të cilat kjo kompani ka marrë dhe pezullimin e tyre deri në plotësimin e rekomandimeve të lëna nga inspektimi, dërguar me shkresën e Ministrit të Mjedisit nr.1389, datë 27.02.2015 “ Raport Përfundimtar i Inspektimit dhe masat e detyrueshme për zbatim”, por që në këto rekomandime nuk ka masa rehabilituese të mjedisit, si dhe faktit të ndotjes të shumëfishtë të shkaktuar nga shpërthimi i ndodhur në fillim të muajit Prill 2015, në zbatim të nenit 62/dh dhe 62/e të ligjit nr.10 431, datë 9.6.2011”Për mbrojtjen e mjedisit”, *rekomandoj*:

- Bashkëpunimin me institucionet përkatëse me detyrime në këtë ligj dhe hartimin dhe më pas kontrollin e programit, me afate kohore të mirë përcaktuara, të rehabilitimit të zonës së ndotur.

- Njoftimin e Kompanisë të afateve kohore të marrjes së masave për rekomandimet e lëna me shkresën e MM me nr.1389, datë 27.02.2015 “Raport përfundimtar i inspektimit dhe masat e detyrueshme për zbatim”

Menjëherë

3. Referuar konstatimit se Kompanisë i janë pezulluar aktivitetet sipas përcaktimit në pikën 1 të masave dhe detyrave të lëna në shkresën e MM me nr.1389, datë 27.02.2015 “Raport përfundimtar i inspektimit dhe masat e detyrueshme për zbatim”, me citimin: “Pezullimi i aktiviteteve të Kompanisë deri në paraqitjen e Planit të Menaxhimit të

Mbetjeve”, si dhe citimi në fund të shkresës se: “Heqja e masës së pezullimit të aktiviteteve të Kompanisë, referuar pikës 1, do të bëhet pas vlerësimit të realizimit të masave dhe detyrave të lëna për zbatim” (ku janë vendosur 6 masa), *por që për këto njoftime të pezullimit nuk është njoftuar QKL, në kundërshtim kjo me pikën 3 të nenit 69 të ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" , rekomandoj:*

- Të bëhet njoftimi zyrtar i Qendrës Kombëtare të Licencimit për masat e propozuara nga inspektimi, konform kërkesave të ligjit nr.10431, datë 9.06.2011 .

Menjëherë

4. Referuar faktit se ISHMP është paditur nga Kompania në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me objekt : Shfuqizimin e Aktit Administrativ të ISHMPU Fier, ku gjobat e vendosura për vitin 2014 janë në vlerën 2.000.000 lekë akt administrativ i vendosur me datën 5.03.2014 “për grumbullim riciklim të hidrokarbureve jashtë kushteve” dhe në vlerën 5.000.000 lekë akt administrativ i datës 31.10.2014 dhe i ankimuar në Inspektorat “ Për mos funksionim brenda kushteve të Gropave Ekologjike”, me synim mbrojtjen e këtyre akteve administrative , ***rekomandoj:***

-Nga ISHMP të bëhet asistimi dhe mbështetja me ekspertë me përvojë të ISHMP dega rajonale Fier në procesin e gjyqimit në Gjykatën Administrative, të akteve administrative të lëshuara nga Inspektorati dhe mbrojtja e tyre në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Në vazhdim

5. Nga auditimi i procedurave të prokuruarra fokusuar në parimet themelore të prokurimit publik, procedurave standarde të procesit të prokurimit si dhe plotësimit të dokumentacionit standard u konstatuan mangësi të lidhura me mungesën e harmonizimit të punës midis njësisë së hartimit të dokumentacionit dhe komisionit të vlerësimit të ofertave, mangësi në hartimin dhe plotësimin e dokumenteve standarde të të gjithë procesit si dhe mangësi në realizimin procedurës sipas një radhe kronologjike. Bazuar në këtë fakt në drejtim të përmirësimit të punës, që do të shoqërohej me një efikasitet të plotë të fondeve në arritjen e objektivave të këtij institucioni, sa trajtuar në faqet 33-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, ***rekomandoj:***

-Institucioni në zbatim të kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, me ndryshimet, Kreu V, pika 1, germa “b”, të marri masa, për të bërë të mundur trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit Publik, nëpërmjet APP-së, në funksion të ngritjes së kapaciteteve që mbulojnë këto funksione.

Vazhdimisht

6. Nga KVO-të të merren masa për të ardhmen, që në rastet e procedurave të tenderit të përdorur “me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, të bëhen negociimet përkatëse me operatorët ekonomik konkurrues, duke kaluar me rigorozitet të gjitha hapat që janë përcaktuar. Kjo në respektim të legjislacionit të prokurimit publik, e konkretisht të Manualit të Agjencisë së Prokurimit Publik, pika 3.2, që cilëson mes të tjerave: “Negociohet me Ofertuesit e Kualifikuar të Seleksionuar si dhe për çdo veprim të kryer, duhet regjistruar në procesverbalet përkatës”.

Vazhdimisht

7. Referuar faktit se nga ISHMPU, janë realizuar shpenzime për dieta edhe për ditët jo zyrtare të punës gjithashtu dokumentacioni bashkëlidhur dietave nuk ishte korrekt, referuar kërkesave të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” të ndryshuar, sa trajtuar në faqet 19-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj**:

- Nga ana e ISHMPU nisur nga fakti i pa bazueshmërisë ligjore të kryerjes së këtyre pagesave, të kërkojë domosdoshmërisht plotësimin ligjor dhe korrekt të dokumentacionit dhe ti qëndrojë faktit të kryerjes së shpenzimeve për dieta vetëm ditëve zyrtare të punës.

Menjëherë

-Gjithashtu nisur nga funksionet ligjore dhe rëndësinë e inspektimit në mjedis dhe pyje, funksione që domosdoshmërisht kryhen dhe në ditët jo zyrtare të punës, nga ISHMP të ndërmerret nisma ligjore, drejtuar ministrisë së linjës për të vazhduar më tej me propozimet përkatëse në Këshill të Ministrave, të përfshirjes në Vendimin e KM nr. nr.997, datë 10.12.2010 të nëpunësve “ Inspektorë “ në kategorinë e punonjësve të administratës që përfitojnë dieta dhe në ditët jo zyrtare të punës.

Menjëherë

8. Është konstatuar se emërimi i të gjithë punonjësve të ISHMP dhe në degët rajonale është bërë nga Ministri i Mjedisit referuar “Kodit të punës, si dhe urdhrit të kryeministrit nr. 56 date 13.02.2014,” Për miratimin e Strukturës dhe organikes se ISHMPU”. *Këto emërime prej 416 punonjësish në nivel qendror dhe rajonal kanë anashkaluar çdo procedure dhe konkurrence, duke u bërë në kundërshtim me ligjin 152/2013 date 01.10.2013 dhe Vendimin nr. 46 date 29.01.2014 kreu V, pika 3 e 5, ku citohet të ndiqen procedurat e statusit te nëpunësit civil. Për këtë rekomandoj që :*

- ISHMP në bashkëpunim me strukturën juridike në të ardhmen të ndjek të gjithë hapat e nevojshëm për rekrutim, duke zbatuar ligjin nr. 152/2013 date 01.10.2013” Për procedurat e statusit të nëpunësit civil dhe aktet në zbatim të tij.

- Procedurat e nisura me DAP për përfshirjen e punonjësve aktualisht në punë në procedurat e emërimit me statusin e nëpunësit civil të vazhdojnë deri në përfundimin dhe normalizimin e këtij procesi konform kërkesave të ligjit.

Menjëherë

9. Referuar konstatimit nga auditimi se nuk është kryer inventarizimi i aktiveve të institucionit në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe konstatimi se mbyllja e pasqyrave financiare të vitit 2014 është bërë pa kryerjen dhe dokumentimin korrekt të gjendjes inventariale, sa trajtuar në faqet 25-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj**:

-Nxjerrjen e urdhrit nga Titullari i Institucionit për kryerjen e inventarizimit fizik të aktiveve të ISHMPU si dhe ngritjen e komisionit të inventarizimit për kryerjen e tij brenda një afati sa më të afërt kohor, për përfundimin dhe nxjerrjen e rezultateve përfundimtare të inventarizimit të cilat duhet të reflektohen menjëherë në kontabilitet.

- Për mjetet e transportit pjesë e inventarit kontabël nga titullari i institucioni të përgatiten dhe miratohen rregulla të brendshme në zbatim të akteve në fuqi për ruajtjen, administrimin dhe menaxhimin me efektivitet të tyre

Menjëherë

10. Nga auditimi për periudhën objekt auditimi është konstatuar se, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve të ISHMPU janë paguar detyrimet për shërbim postar mbi bazën e faturave të lëshuara nga Posta Shqiptare, në një kohë që këto fatura shpesh herë nuk paraqisnin sasinë e shërbimit dhe çmimin për njësi shërbimi dhe njëkohësisht pa u kryer konfirmimi për saktësinë e sasisë së shërbimit nga punonjësit e Arkiv-Protokollit të UAMD. Për efekt të shmangies së pagesave për shërbime të pa kryera, sa trajtuar në faqet 19-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj**:

-Nga zyra e financës së institucionit, referuar udhëzimeve të Ministrisë së Financave në fuqi për zbatimin e buxhetit dhe për një menaxhim sa më efektiv të fondeve buxhetore, kryerja e pagesave të bëhet vetëm mbas sigurimit të dokumentacionit vërtetues të mjaftueshëm të kryerjes së shërbimit.

Menjëherë

11. Referuar faktit se nga ISHMPU nuk janë hartuar, dokumenti i deklaratës së vetëvlerësimit dhe raporti i cilësisë, i cili dërgohet zyrtarisht në Ministrinë e Mjedisit dhe në Ministrinë e Financave referuar nenit 18 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, për efekte të plotësimit me rigorozitet të kërkesave ligjore, duke pasur në konsideratë se këto dokumente japin opinione të rëndësishme mbi funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit brenda institucionit, sa trajtuar në faqen 49-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandoj**:

-Nga Inspektorati duhet që në deklaratimet për vitin 2014, të cilat bëhen brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës në institucionet përkatëse, në plotësim të kërkesave ligjore, të dorëzohet pyetëtori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit së bashku me deklaratën dhe raportin e cilësisë. Gjithashtu nga ISHMPU të hartohet strategjia e riskut, referuar risqeve të realizimit të objektivave të identifikuara aktualisht.

Deri më 31 Mars 2015

12. Referuar konstatimit nga auditimi, se në ISHMPU nuk kishte rregulla të brendshme të miratuara për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të përdorimit të fondeve buxhetore për shpenzimet për paga, operative sipas llojit, për administrimin e aseteve dhe materialeve të institucionit si dhe të rregullave të procedurave të prokurimit publik, me synim që të sigurohet se të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë që u mundëson audituesve të brendshëm e të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, **rekomandoj** :

-Nga N/A dhe Titullari i institucionit, ku aktualisht në ISHMPU Nëpunësi Autorizues është dhe Titullar institucioni, në zbatim të nenit 9, pika 2 dhe nenit 16, pika 2, të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të hartohen dhe të miratohen rregullat për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të shpenzimeve, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave në zbatim të Ligjit.

Menjëherë

13. Nga auditimi i prokurimeve u konstatua:

a. Se regjistri i realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi, nuk ishte i plotësuar në mënyrë të rregullt konform formularëve standard të miratuar nga APP .

b. Gjithashtu nuk është krijuar regjistri për të gjitha procesverbalet për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit në përputhje me nenin 12 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”. **Për këtë rekomandoj që:**

- Të hartohen për periudhat në vazhdim regjistri i parashikimeve dhe regjistri i realizimit të prokurimeve, me të gjitha të dhënat e nevojshme të përcaktuara në dokumentet standard, duke pasqyruar hap pas hapi çdo ndryshim të fondeve dhe objekteve
- Të krijohet regjistri i prokurimeve, nga njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave në përputhje me LPP, kreu II, neni 12, pika 3.

Vazhdimisht

14. Referuar faktit se nga titullari i autoritetit kontraktor nuk është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të objektit ashtu dhe për mallrat e furnizuara në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ***rekomandoj:***

-Të merren masa nga Titullari i ISHMPU-së për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim për çdo rast të marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara dhe për çdo rast të punimeve të kryera, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Në vazhdimësi.

15. Referuar shkeljeve të konstatuara në kompletimin e dosjeve të prokurimit, dhe në protokollimin në kohë të tyre, ***rekomandoj:***

-Të kryhet inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve të prokurimeve publike për vitin 2014 e në vazhdim, me të gjitha dokumentet duke përfshirë dhe raportin e realizimit të kontratës.

Menjëherë

16. Nga auditimi rezultoi se, pronat e paluajtshme në administrim të ISHMPU referuar vendimit të KM nr. 273, datë 07.05.2014, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të mjediseve nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencia Telegrafike Shqiptare te Ministria e Mjedisit dhe institucionet në varësi të saj dhe për një ndryshim në vendimin nr. 444, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Agjencisë Telegrafike Shqiptare", nuk janë regjistruar në Regjistrin e Pronave të Paluajtshme, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. ***Për këtë rekomandoj:***

-Të përgatitet dokumentacioni ligjor i pronësisë për objektet që i janë vënë në dispozicion ISHMPU në qendër si dhe degëve rajonale në zbatim të akteve përkatëse, të cilat kanë përcaktuar vënien në dispozicion të këtyre pronave dhe të kryhet regjistrimi Pronave të Paluajtshme në ZVRPP përkatëse.

Menjëherë

17. Gjatë auditimit të vlerësimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në ISHMPU u konstatua se:

a. Nga strukturat drejtuese, nuk është hartuar dhe miratuar “Deklarata e Misionit” të ISHMPU dhe nuk ka një Strategji, e cila të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë, përgjegjës për realizimin e tyre;

b. Nuk është krijuar Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), sipas kërkesave të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit, nuk është caktuar Koordinatori i Riskut dhe Strategjia

e Menaxhimit të Riskut, për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të institucionit, të përcaktuara gjatë planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe vjetor. ***Për këtë rekomandoj:***

-Mbështetur në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Titullari i institucionit me strukturat e tij, të hartojë “Deklaratën e misionit”, strategjinë, objektivat dhe planet e veprimit për arritjen e qëllimeve, duke përcaktuar personat përgjegjës për këtë qëllim, të krijojë dhe miratojë Grupin për Menaxhimin Strategjik (GMS), Koordinatorin e Riskut dhe Strategjinë e Menaxhimit të Riskut.

Menjëherë

18. Gjatë auditimit të vlerësimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, u konstatua se:

a. Nuk monitorohen nga Titullari dhe strukturat e tij, njësitë në varësi, mbi efektivitetin e të gjitha sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të këtyre njësive. ***Për këtë rekomandoj:***

- Të monitorohen nga Titullari dhe strukturat e tij, efektiviteti i të gjitha sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të institucioneve të varësisë dhe të raportohet për efektivitetin e këtij sistemi. Ky monitorim të bëhet dhe për procesin e hartimit të programeve buxhetore afatmesme dhe vjetore si dhe monitorimin e realizimit të objektivave dhe produkteve dhe fondeve të alokuara për realizimin e tyre.

Në vazhdimësi.

19. Nga auditimi ka rezultuar se nga ana e ISHMP janë kryer me vonesë pagesat e energjisë elektrike për muajt Gusht, Tetor të vitit 2014 dhe të telefonisë fikse pagur Albtelekomit për muajt Tetor dhe Gusht të vitit 2014, në kundërshtim me afatet e vendosura për kryerjen e këtyre pagesave nga këto kontraktorë, sa trajtuar në faqet 19-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. ***Për këtë rekomandoj :***

-Nga ISHMPU të kryhen rakordimet me dhe si dhe të kryhen pagesat për kamat vonesat e konstatuara dhe të rakorduara . Për kamat vonesat e vendosura si pasojë e pagesave me vonesë të faturave, të nxirret përgjegjësia nga titullari i institucionit dhe të kryhet arkëtimi i shumave nga punonjësit përgjegjës,

Menjëherë

20. Referuar konstatimit që dokumentacioni standard i procedurave të blerjeve me vlera të vogla në disa raste nuk është plotësuar tërësisht, pasi nuk është bashkëlidhur fletëhyrje e mallit, ose mallrat apo punimet nuk janë marrë në dorëzim për të konfirmuar plotësimin e kërkesave të kontraktuara, në kundërshtim me Udhëzimin nr.2 datë 18.02.2008, “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ***rekomandoj:***

- Nga strukturat përgjegjëse të administrimit të këtyre dokumenteve të merren masa për përpilimin dhe plotësimin e tyre, sipas kërkesave të udhëzimeve të cituar më sipër.

Menjëherë

21. Referuar konstatimit nga auditimi se në ISHMP janë kryer ndalesat për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi në mënyrë jo të rregullt, dhe jo në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe nuk janë reflektuar në përlllogaritjet e këtyre detyrimeve ndryshimet koherente të ligjit të ndodhura përgjatë vitit 2014, ku sipas përlllogaritje të kryera kanë rezultuar diferenca për çdo muaj në disa punonjës .

rekomandoj:

-Zyra e Financës së ISHMPU të marrë masa që të bëjë korrektime përkatëse sipas konstatimeve të rezultuara nga auditimi i KLSH sipas tabelës bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Këto korrektive të kryen dhe për muajt e tjerë të pa audituar nga Grupi i KLSH

Menjëherë

22. Nga auditimi u konstatua se janë paguar në organin tatimor në vitin 2014, vlera 5,928,807.00 lekë kontribut i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe 1,442,360.00 lekë tatim i të ardhurave nga punësimi. Këto pagesa nuk janë të plota dhe nuk janë bërë në kohë, ku në muajin Mars rezultoi të ketë diferencë në vlerën 66.603 leke me pak për sigurimet shoqërore dhe për muajin Prill 14.227 leke me shume për tatimin e të ardhurave nga punësimi. **Për këtë rekomandoj që:**

- Nga zyra e financës së ISHMPU mbas kryerjes së pagesave sipas detyrimeve ligjore për çdo person për vitin 2014, të bëjë rakordimet përkatëse në organet tatimore përgjegjëse për diferencat e pa paguara, duke ndjekur të gjitha hapat procedurale në fuqi, në mbështetje kjo të VKM Nr. 1114, datë 30.7.2008, "Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Menjëherë

23. Nga auditimi u konstatua se punonjësve të ISHMP u janë mbajtur në muajin Mars 2014 nga paga mujore, sigurime shtetërore suplementare në vlerë totale prej 51,801 lekë. Këto sigurime nuk janë derdhur për llogari të sigurimeve shtetërore suplementare. **Për këtë rekomandoj që:**

-ISHMPU të marrë masa për kthimin punonjësve të saj, vlerat e mbajtura për sigurimet shtetërore suplementare dhe të pa derdhura në shumën 51,801 lekë.

-Mbështetur në ligjin nr. 8097, datë 21.03.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", i ndryshuar me ligjin nr. 9990 date 15.09.2008, neni 1 pika 9, si dhe referuar kërkesave të Vendimit nr 488, date 21.09.2000 pika 3 dhe 4, të ndërmarrë hapat përkatëse për përfshirjen e punonjësve të institucionit në listën e punonjësve me detyrimin, konform ligjit, të pagesave të sigurimeve suplementare.

Menjëherë

24. Nga auditimi u konstatua se mbi shumën e raporteve mjekësore të paguara nga institucioni, nuk janë llogaritur dhe ndaluar kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, në kundërshtim me udhëzimin nr. 26, datë 16.04 2009 të Ministrit të Financave, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", kapitulli VIII, "Të tjera", pika 3. **Për këtë rekomandoj që:**

-Zyra e Financës së ISHMP të marrë masa që për raporte për paaftësi të përkohshme në punë të aplikojë ndalesa për sigurimet shoqërore si dhe tatimin mbi të ardhurat personale, në zbatim të akteve ligjore në fuqi. Për vitin 2015 e në vazhdim për sa më sipër referenca ligjore

është vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 77, date 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

Menjëherë

25. Nga auditimi u konstatua se në disa dosje të punonjësve të marrë rishtas në punë ka disa mungesa të pjesshme. Gjithashtu dosjeve të personelit u mungonte inventari mbi përmbajtjen e tyre, në kundërshtim kjo me kërkesat e ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “ Për Arkivat” në Republikën e Shqipërisë. **Për këtë rekomandoj që:**

-Zyra e burimeve njerëzore të ISHMPU të marre masa në plotësimin dhe mbajtjen e dosjeve të personelit në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “ Për Arkivat në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet në fuqi për zbatimin e ligjit për Statusin e Nëpunësimit Civil.

Menjëherë

26. Referuar konstatimit nga auditimi se në strukturën e ISHMP nuk ka të parashikuar strukturë auditimi të brendshëm, në kundërshtim me përcaktimin në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 46, datë 29.01.2014, kreu III. pika 6/ b. si dhe kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 212, datë 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive për Auditin e Brendshëm në sektorin publik”, **rekomandoj:**

-ISHMPU në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Mjedisit, të marre masa për ngritjen e një strukture të auditit të brendshëm në zbatim të akteve në fuqi.

Menjëherë

27. Nga auditimi i kryer rezulton se ISHMP, ka një rregullore të brendshme të miratuar me nr.1159 prot. datë 15.09.2014, mbi bazën e së cilës ka funksionuar institucioni. Ajo përmban përshkrimet e punës se çdo pozicioni pune sipas struktura e saj, por nuk reflekton nivelet e hierarkisë mbi të cilin çdo punonjës referon si dhe nuk janë inplementuar detyrimet që burojnë nga ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i Ministrisë së Financave. **Për këtë rekomandoj që:**

-ISHMP të marre masa në hartimin e një rregullore të brendshme të re, ku të reflektoje më qartë pozicionet e punës si dhe të pasqyrojë në të detyrimet që burojnë nga ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe aktet në zbatim të tij.

Menjëherë

28. Nga auditimi i kryer ka rezultuar se nuk është hartuar dhe mbajtur në mënyrë periodike libri i pagave në institucion, referuar Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 **Për këtë rekomandoj që:**

- ISHMP të marre masa në hartimin e librit të pagave për çdo punonjës dhe kryejë azhurnimin e tij për çdo vit kalendarik.

Menjëherë

29. Referuar faktit të konstatuar nga auditimi se në fletë udhëtimet e mbajtura nuk janë evidentuar destinacionet përfundimtare të shkuarjes në rrethet përkatëse, por janë vendosur qendrat e rrethëve, duke u nisur dhe nga specifikat që ka ky inspektorat në inspektimin në mjedis, pyje dhe ujëra (pra destinacione larg qendrave urbane), për efekt të shmangies së interpretimeve jo të bazuara në dokumente dhe jo korrekte me aktet në fuqi, **rekomandoj:**

- ISHMPU të bashkëpunojë me Ministrinë e Transporteve për të marrë referencat e distancave për ato distanca kilometrike të cilat nuk janë të publikuara zyrtarisht, për çdo rreth.
- Në fletët e udhëtimeve të cilat justifikojnë itinerarin e përshkruar, të vendosen destinacionet përfundimtare të udhëtimit dhe jo vetëm qendrat e qyteteve.

Menjëherë

30. Referuar konstatimit nga auditimi se nga Drejtoritë e inspektimit në ISHMP nuk ka një standard të mbajtjes së regjistrit si dhe të dhënave që duhet të përmbajë ky regjistër, ku domosdoshmërisht duhet të përfshihet dhe arkëtimi i gjobave, për rrjedhojë ankimimi i tyre, dërgimi në gjykatë i gjobave të mbetura në fuqi si dhe e atyre të pa ankimuara dhe të pa derdhura vullnetarisht, ***rekomandoj:***

- Nga ISHMP të parashikohet ngritja e një sistemi të integruar informatik online për marrjen e informacionit të inspektimit dhe monitorimit në kohë reale si dhe ndjekja e vjeljes së gjobave zbatimit të rekomandimeve nga subjektet, referuar konstatimeve nga inspektimi.

Menjëherë

- Për periudhën aktuale deri në krijimin e një sistemi informatik, të ndërtohet një regjistër standard me të gjithë të dhënat e nevojshme të monitorimit për të tre drejtoritë mjedis, pyje, ujëra, si dhe të vendosen afatet e raportimit për Drejtoritë Rajonale të ISHMPU.

Menjëherë

31. Referuar konstatimit nga auditimi se Komisioni i Shqyrtimit të Ankimimeve ishte krijuar në fund të vitit 2014 dhe faktit se ankesat e shqyrtuara ishin në një numër të vogël, në masën 17.3 % e atyre të paraqitura, për efekt të shmangies së fenomenit të shuarjes së gjobave mbas kalimit të afatit 2 vjeçar mbështetur në përcaktimet ligjore në fuqi, ***rekomandoj:***

- Nga Titullari i ISHMP të ndërmerren masa që shqyrtimi i ankimimeve për gjobat e vendosura nga inspektimi gjatë vitit 2014 të përfundojë brenda periudhës së 4 mujorit të parë të vitit 2015.

- Shqyrtimi i gjobave nga ana e Komisionit të Ankimimeve të bëhet progresivisht sipas periudhës kohore.

Menjëherë

32. Nga auditimi u konstatua se nga mos pagimi në kohe, dhe përlogaritja jo e saktë për shumën e vete deklaruar për kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi në faqen zyrtare të Tatim Taksave rezulton, që për vitin 2014, të konstatuar deri në datë 20.02.2015, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve dhe Ujerave ka detyrime të pa paguara në vlerën 629,419 leke, gjoba në vlerën 11,228 leke dhe interesa të pa paguar në vlerën 3,026 leke, të gjitha në një totale prej 643,678 lekë. ***Referuar këtij fakti rekomandoj që:***

- Nga zyra e financës së ISHMPU të marren masat përkatëse për rakordimin dhe kryerjen e pagesave sipas përcaktimeve ligjore. Për diferencat e rezultuara si gjoba dhe si kamat vonesa në shumën **14,254 lekë**, pas rakordimeve përfundimtare të kryhen pagesat përkatëse, të nxirren përgjegjësitë dhe të arkëtohen shumat e paguara si detyrim gjobe dhe kamatëvonesë nga punonjësit përgjegjës.

B.MASA SHPËRBLIM DËMI

1.Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e demit **prej 397.771,2 lekë** nga operatori **ekonomik** për punë të pakryer sipas zërave të verifikuar të preventivit, krahasuar me librezën e masave dhe në fakt, për rikonstruksionin e godinës 2 katëshe të ISHMPU.(sa trajtuar në faqen 33-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.(mbajtur procesverbali me nr.274/4 datë 26.02.2015)

Menjëherë

2.Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e demit **prej 1,460,190.6 lekë** nga studio e projektimit për përlogaritje të fondit limit më të lartë, si rezultat i vendosjes së çmimeve të disa zërave punimesh në preventivin e hartuar, me vlera më të larta në krahasim me përcaktimet në manualin e çmimeve të ndërtimit të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.568, datë 27.06.2013,sa trajtuar në faqen 33-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.(mbajtur procesverbali me nr.274/3 datë 26.02.2015)

Menjëherë

3. Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e shumës së demit ekonomik prej **117,226.9 lekë** të shkaktuar **nga z.....** si rezultat i shpërndarjes së karburantit më tepër për punën e kryer, nga sa e përcaktojnë normativat teknike të harxhimit të karburantit të mjeteve të përdorura, në një kohë që këto mjete janë mjete të reja dhe pa asnjë vit amortizim, sa trajtuar në faqet 27-32 të Raportit Përfundimtar të auditimit. (mbajtur procesverbali i datës nr.274/5 datë 27.02.2015)

Menjëherë

4. Të kontabilizohen dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e shumave të përfituara padrejtësisht si më poshtë:

b. Për shumën **33,000 lekë**, përfituar nga 6 punonjës,në kundërshtim me VKM nr.997,datë 10.12.2010 "*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit*", sipas listës bashkëlidhur Raportit, sa trajtuar në faqet 19-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. (mbajtur procesverbali me protokoll 274/1 , datë 23.02.2015)

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

C1. Mbështetur në nenin 58 "llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", nenit 57 si dhe nenit 59 të ligjit , gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin,përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Largim nga shërbimi civil ", neni 58, germa "ç" për zotin

-Në pozicionin e Drejtorit të Shërbimeve dhe Financës: Për mos dokumentimin automjeteve të cilat nuk ndodheshin në ambientet e ISHMPU-së dhe nuk rezultojnë nga pikëpamja

dokumentare të mara në përdorim nga asnjë punonjës i institucionit ose jashtë tij , veprim që bie në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, kapitulli I, pika 2, pikën 10, në kundërshtim me pikën 54, të udhëzimit nr. 20, datë 17.11.2014, si dhe në kundërshtim me nenin 34. Është mbajtur procesverbali përkatës

-Në pozicionin e N/Z Për mos kryerje të inventarit të aktiveve të institucionit në kundërshtim me udhëzimin 30 si dhe moskontabilizimin konform ligjit, dhe transferimin e tyre brenda sistemit jo me procedura dhe miratim dokumentacioni në kundërshtim me këtë udhëzim. Për hartim të pasqyrave financiare jo në zbatim të udhëzimeve në fuqi për kontabilitetin.

-Në pozicionin e Drejtorit të Shërbimeve dhe Financës Për dëmin ekonomik prej **117,226.9 lekë** të shkaktuar si rezultat i shpërndarjes së karburantit llogaritur më tepër për automjetet referuar km të përshkruara dhe normativës reale të konsumit të këtyre mjeteve, duke përcaktuar jashtë procedurave të rregullta ligjore normativa shumë të larta konsumi të karburantit, në një kohë që këto mjete ishin mjete të reja dhe pa asnjë vit amortizim. Është mbajtur procesverbali përkatës

- Në funksionet e N/Z: Për moskryerje të funksioneve në njohje dhe zbatim të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

-Në Funksionet e N/Z Për miratimin e urdhër shpenzimeve për pagimin e dietave për punonjësit e institucionit për ditët jo zyrtare të punës. Është mbajtur procesverbali përkatës.

Në Funksionet e N/Z: Për ndalesat e kryera për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi në mënyrë jo të rregullt, jo në përputhje me legjislacionin si dhe nuk janë paguar në afatet përkatëse në kundërshtim me: VKM nr. 1114, datë 30.7.2008 “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11. 05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012, “Për tatimin mbi të ardhurat” etj. Në pozicionin e kryetar të NJPP në lidhje me procedurat e tenderit me objekt, “Rikonstruksioni i godinës 2-katëshe të ISHMPU-së”, janë konstatuar problematika për të cilat është vepruar në kundërshtim me LPP nr. 9643, datë 20.11.2006, dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 dhe konkretisht;

-Njoftimi me shkresë titullarit të AK për përcaktimin e fondit limit (sipas NJP i janë referuar studios së projektimit), përpara lidhjes së kontratës me studion e projektimit

-Mos respektimi i afatit të zhvillimit të tenderit në lidhje me ftesën për ofertë operatorëve ekonomikë.

-Miratimi i DST-ve janë bërë pasi janë dërguar ftesat për ofertë operatorëve ekonomikë.

-Nuk janë ndjekur hapat e duhur për zhvillimin e gjithë procesit të procedurës së tenderit.

Për sa më sipër është mbajtur procesverbali me nr. 274/3, datë 26.02.2015.

C2. Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, nenit 57 si dhe nenit 59 të ligjit , gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin,përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“vërejtje “neni 58” gërma a për znj.

Për pozicionin e specialistes së financës : Për miratimin e urdhër shpenzimeve për pagimin e dietave për punonjësit e institucionit për ditët jo zyrtare të punës. Është mbajtur procesverbali përkatës.

Për ndalesat e kryera për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi në mënyrë jo të rregullt, jo në përputhje me legjislacionin si dhe nuk janë derdhur në organet tatimore në afatet përkatëse në kundërshtim me: VKM nr. 1114, datë 30.7.2008 “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11. 05.1993 “Për sigurimet

shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012, "Për tatimin mbi të ardhurat" etj. Për hartim të pasqyrave financiare jo në zbatim të udhëzimeve në fuqi të kontabilitetit dhe jo të rakorduara postet e bilancit. Trajtuar gjerësisht në Rubrikën mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

C3. Mbështetur në nenin 58 "llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", nenit 57 si dhe nenit 59 të ligjit , gjithashtu mbështetur në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", kërkojmë që nga Titullari i ISHMP në varësi të analizës dhe nivelit të arkëtimit të gjobave për çdo Drejtori Rajonale të fillojnë **procedurat për dhënien e masave disiplinore nga "vërejtje" deri në "largim nga detyra" :**

për zotërinjtë:

Për Drejtorinë Rajonale Elbasan:

z.....Kryeinspektor,

z.....Jurist.

Për Drejtorinë Rajonale Lezhë:

z.....Kryeinspektor,

z.....Jurist.

Për Drejtorinë Rajonale Fier:

z..... Kryeinspektor,

z..... Jurist.

Për Drejtorinë Rajonale Durrës

z.....Kryeinspektor,

z.....Jurist.

Për Drejtorinë Rajonale Tiranë:

z.....Kryeinspektor,

z.....Jurist.

Për Drejtorinë Rajonale Shkodër:

z.....Kryeinspektor ,

z.....Jurist.

Për Drejtorinë Rajonale Gjirokastrë:

z..... Kryeinspektor ,

z.....Jurist.

Për Drejtorinë Rajonale Kukës:

z.....Kryeinspektor,

z.....Jurist.

Për Drejtorinë Rajonale Berat:

z.....Kryeinspektor,

z.....Jurist.

Për Drejtorinë Rajonale Dibër:

z.....Kryeinspektor,

z.....Jurist.

Për Drejtorinë Rajonale Vlorë :

z.....Kryeinspektor,

z.....Jurist.

Për Drejtorinë Rajonale Korçë :

z.....Kryeinspektor

z.Jurist

Mbështetur në ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” nenin 44 të ligjit “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, ku citohet se: *“Në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative nuk paguhen për mosveprim të punonjësit të organit administrativ i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave , apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e largimit nga detyra.”*

Referuar fakteve të arkëtimit të gjobave në shumën totale 3,140 mijë lekë për vitin 2014, kundrejt vendosjes së tyre në këtë vit në shumën 246,031 mijë lekë sipas drejtorive rajonale trajtuar gjerësisht në rubrikën e të ardhurave të institucionit në faqet 8 deri në faqen 13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, në mbështetje të nenit 44 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, mbajnë përgjegjësi Kryeinspektorët e drejtorive rajonale dhe juristët, të cilët duhet të vepronin në bazë të funksioneve dhe autoritetit të tyre si dhe ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Nikoleta Piranjani, Erion Muho, Migena Nushi më tej materiali u shqyrtua më tej u shqyrtua nga k/auditues Fatmir Ilizai, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj.